

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MADI GROUP” sh.p.k.

Sot, më datë 01.08.2024, në Tiranë, Shqipëri, personat e mëposhtëm:

• Z Klodian Sulejmani, atësia Astrit ,mëmësia Silvana, lindur me 18.09.1985, ne Durrës, dhe banues ne Durrës, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim me numer: 034679931, dhe me numer personal: I509180570;

vendosi të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

Neni 1

Themelimi

1.1 Emri i shoqërisë është “MADI GROUP” Sh.p.k., këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”. Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.

1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe statutin.

Neni 2

Selia

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Blv.”Gjergj Fishta”,Nj.7 Tirane, Tiranë.

2.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës sëShqipërisë dhe/ose jashtë saj.

Neni 3

Objekti

3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:

A. Bar – Kafe, Restorant dhe shërbime që lidhen me këto veprimtari, catering.

B. Tregtimi me shumice dhe pakice i produkteve industriale, import dhe eksport i produkteve dhe materialve te ndryshme industriale, dhe produkteve ushqimore.

C. Çdo veprimtari tjetër e ligjshme.

Neni 4

Kohëzgjatja

4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortakët

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 (Një qind mijë) **Lek**.

5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortaku i veyëm:

- **Z. Klodian Sulejmani**, 1 (një) kuotë, me vlerë nominale ALL 100,000 (Një qind mijë lek), duke përfaqësuar 100% (Një qind) të kapitalit themeltar me të drejtë vote;

5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.

5.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6

Asambleja e Përgjithshme

6.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

Neni 7

Administratori

7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

7.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:

- **Z. Klodian Sulejmani**, shtetas Shqiptar, lindur me 18.09.1985, ne Durrës, dhe banues ne Durrës, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim me numer: 034679931, dhe me numer personal: I509180570.

7.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.

7.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit dhe të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Neni 8

Viti Financiar

8.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo vitikalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.

8.2 Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2024.


Neni 9

Të ndryshme

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar dhe nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë secila.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "MADI GROUP" sh.p.k

Klodian Sulejmani



Datë 01.08.2024